

**No. 16689**

---

**FRANCE  
and  
ALBANIA**

**Phytosanitary Convention (with annex). Signed at Tiranë  
on 31 December 1977**

*Authentic texts: French and Albanian.*

*Registered by France on 11 May 1978.*

---

**FRANCE  
et  
ALBANIE**

**Convention phytosanitaire (avec annexe). Signée à Tirana  
le 31 décembre 1977**

*Textes authentiques : français et albanais.*

*Enregistrée par la France le 11 mai 1978*

[ALBANIAN TEXT — TEXTE ALBANAIS]

## KONVENTE FITOSANITARE MIDIS QEVERISE SE REPUBLIKES FRANCEZE DHE QEVERISE SE REPUBLIKES POPULLORE SOCIALISTE TE SHQIPERISE

Qeveria e Republikës Franceze dhe Qeveria e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, të nisura nga dëshira që të bashkëpunojnë për të luftuar në mënyrë të efektshme kundër armiqve të bimëve, që të menjanohet veçanërisht hyrja dhe përhapja e demtuesve dhe semundjeve të rrezikshme në vendet e tyre respektive dhe me qëllim që të ndihmohen për zhvillimin e marrëdhënieve tregtare midis të dy vendeve, kanë vendosur të perfundojnë këto Konvente.

*Neni 1.* Me qëllim që të parandalohet hyrja dhe përhapja e armiqve të rrezikshëm të bimëve me anë të shkëmbimeve tregtare ose të tjera, Palet Kontraktuese marrin përsiper:

- a) Të ndalojnë eksportimin e bimëve dhe të prodhimeve bimore, kur këto mund të futin ose të përhapin në territorin e palet tjetër kontraktuese semundje dhe demtues që konsiderohen si të rrezikshëm.
- b) Të shoqërojnë me “çertifikate fitosanitare”, të leshuannaga organi kompetent i mbrojtjes së bimëve të vendit eksportues, deri gimin e bimeve ose prodhimeve bimore. Çertifikata duhet të deshmohet se rregullat fitosanitare të vendit importues janë respektuar dhe të përmendin vendin nga vijne këto bimë e prodhime bimore dhe trajtimet neqoftese u janë bërë. Çertifikata fitosanitare do të përmbajë, kur të paraqitet nevojja, çdo njoftim tjetër plotësues që do të kërkojë nga shërbimi qendror i mbrojtjes së bimëve të vendit importues;
- c) Dheu dhe materialet me origjinë bimore që janë përdorunper amballazhimin e bimëve dhe të prodhimeve bimore duhet t’u përgjigjen kushteve fitosanitare të vendit importues.

*Neni 2.* Në këto Konvente:

Me “bimë” kuptohen bimët e gjalla dhe pjesët e bimëve gjalla;

Me “prodhime bimore” prodhimet e painedustrializuara me origjinë bimore, duke përfshirë dhe farerat;

Me “armiqtë e bimëve” agjentet fitopatogjene, demtuesit e bimëve dhe barerat e keqija.

*Neni 3.* Lista e armiqve kryesore të bimëve, që konsiderohen si të rrezikshëm, për të cilat është rënë dakord të evitohet hyrja dhe përhapja në territorin e sejciles nga Palet Kontraktuese, është përcaktuar nga ekspertet e të dy paleve dhe i aneksohet kesaj Konvente.

Kjo listë mund të plotësohet ose të ndryshohet nga shërbimet qendrore të ngarkuara me mbrojtjen e bimëve dhe me kontrollin fitosanitar të Paleve Kontraktuese. Shtesat ose ndryshimet do t’i njoftohen palet tjetër në rrugë diplomatike dhe do të hyjnë në fuqi 60 dite pasi të merret njoftim nga shërbimi qendror i mbrojtjes së bimëve.

*Neni 4.* Palet Kontraktuese marrin persiper:

- a) Te mbikqyrin ne te gjithë territorin e tyre shfaqjen dhe zhvillimin e armiqve te rrezikshem te bimeve;
- b) Te keshillojne ekonomite bujqesore dhe pyjore per masat paraprake dhe te luftes kunder semundjeve dhe demtuesve te rrezikshem te bimeve dhe te mbikqyrin zbatimin e ketyre masave;
- c) Te informojne njera tjetren me shkrim per shfaqjen dhe zhvillimin ne territorin respektiv te tyre te armiqve te bimeve qe konsiderohen si te rrezikshem dhe per masat e zbatuara per luftimin e tyre.

*Neni 5.* Pajisja e bimeve dhe prodhimeve bimore qe eksportohen me certifikate fitosanitare, nuk i heq te drejten vendit importues te beje kontrollin e vet dhe te zbatoje masa te tjera te nevojeshme qe kerkon gjendja fitosanitare e mallrave ne fjale.

Kur ne keto mallra konstatohen semundje ose demtues te bimeve qe konsiderohen si te rrezikshem, vendi importues njofton sa me shpejt qe te jete e mundur sherbimin qendror te mbrojtjes se bimeve te vendit eksportues si dhe per masat e posaçme qe ka vendosur te marre.

*Neni 6.* Dispozitat e kesaj Konvente duhet te zbatohen per importimet e te gjitha bimeve ose prodhimeve bimore, cilidoqofte destinatori i tyre.

*Neni 7.* Importimi dhe tranziti i bimeve dhe prodhimeve bimore do te kryhet nepermjet porteve, aeroporteve dhe pikave te kalimit kufftare, qe do te caktohen ne marreveshje midis organeve kompetente, mequellim qe te sigurohet kontrolli fitosanitar.

*Neni 8.* Me quellim qe te sigurohet shkembimi i eksperiences shkencore dhe praktike ne fushen e mbrojtjes se bimeve, Palet Kontraktuese bien dakord:

1. Te kembejne ne menyre reciproke:
  - a) Materialet qe trajtojne legjislacionin fitosanitar te vendeve perkatese;
  - b) Sipas mundesive botime me karakter tekniko-shkencor e praktik qe kane te bejne me mbrojtjen e bimeve;
2. Te organizojne vizita midis specialisteve te mbrojtjes se bimeve te te dy vendeve, me inisiativen dhe shpenzimet e pales e kerkon, pasi te konsultohet e te bjere dakord me palen tjetere.

*Neni 9.* Veshtiresite qe mund te lindin lidhur me zbatimin e kesaj Konvente do te zgjidhen bashkerisht nga sherbimet qendrore te mbrojtjes se bimeve te Paleve Kontraktuese.

Veshtiresite qe nuk do te mund te zgjidhen ne kete menyre do te rregullohen ne rruge diplomatike.

*Neni 10.* Dispozitat e kesaj Konvente nuk cenojne zotimet e tjera nderkombetare te Paleve Kontraktuese ne fushen fitosanitare.

*Neni 11.* Kjo Konvente eshte e vlefshme per 3 vjet, duke filluar nga data e hyrjes ne fuqi. Ajo vazhdon te zgjatet ne menyre te heshtur nga viti ne vit, ne rast se asnjera nga palet kontraktuese nuk e denoncon 6 muaj perpara mbarimit te afatit.

*Neni 12.* Kjo Konvente do te hyje ne fuqi 60 dite mbas dates se neneshkrimit.

BERE ne Tirane, me 31 dhjetor 1977 ne dy kopje secila ne gjuhen frengjisht e shqipe. Te dy tekstet jane autentike.

Per Qeverine  
e Republikes Franceze:

[Signed — Signé]<sup>1</sup>

Per Qeverine  
e Republikes Popullore  
Socialiste te Shqiperise:

[Signed — Signé]<sup>2</sup>

LISTA E ARMIQVE KRYESORE TE BIMEVE QE I ANEKSOHET KONVENTES  
FITOSANITARE MIDIS REPUBLIKES FRANCEZE DHE REPUBLIKES  
POPULLORE SOCIALISTE TE SHQIPERISE

I. *Semundje virusale* (Viruses)

1. *Court noué*
2. *Prunus virus 7* (*Plum pox*)
3. *Citrus tristeza*
4. Psoroza e agrumeve
5. Xiloporozja e agrumeve
6. *Potato yellow vein virus*
7. *Potato spindle tuber virus*

II. *Semundjet bakteriale* (Bacteria)

1. *Corynebacterium sepedonicum* (Spieck et Coth).
2. *Xanthomonas stewartii* (E. F. Smith)
3. *Corynebacterium michiganense* (Smith) Jensen
4. *Xanthomonas citri* (Hasse) Dowson
5. *Erwinia amylovora* (Burrill). Com. S.A.B.
6. *Pseudomonas syringae* (*citriputeale*) (Smith) Stapp.
7. *Agrobacterium tumefaciens* (Smith et Towns).
8. *Aplanobacterium populi* Ridie

III. *Semundje kerpudhore* (Fungus)

1. *Diplodia zaeae* (Schw) Lev.
2. *Colletotrichum gossypi* Southw.
3. *Synchytrium endobioticum* (Schilb). Perc.
4. *Deuterophoma tracheiphilla* Petri.
5. *Sphaeropsis malorum* Peck.
6. *Endothia parasitica* (Murr) And et And.
7. *Phymatotrichum omnivorum* (Shear.) Duggar.
8. *Tilletia indica* (Mittra) Mundkur.

9. *Hypoxyton pruinaum* (Klotzsch) Cke

IV. *Nematode fitopatogjene* (Nematodes)

1. *Aphelenchoides oryzae* Yokoo
2. *Ditylenchus destructor* Thorne
3. *Heterodera rostochiensis* Woll.
4. *Heterodera schachtii* Schmidt.

V. *Insekte te demeshme* (Insects)

1. *Ceroplastes japonicus* Greem
2. *Popillia japonica* Newn.
3. *Laspeyresia molesta* Busck
4. *Hyphantria cunea* Drury
5. *Quadrupidiotus perniciosus* Comst.
6. *Pseudococcus comstocki* Kuw
7. *Pthorimaea operculella* Zell
8. *Pseudococcus citriculus* Green
9. *Unaspis citri* Gomst.
10. *Ceratitits capitata* Wied
11. *Tetradacus citri* Chen
12. *Callasobruchus chinensis* L.
13. *Callosobruchus maculatus* Fabr.
14. *Trogoderma granarium* Everest
15. *Calandra zaeae-mays* Motsch
16. *Leucaspis japonica* ckl.
17. *Rhagoletis pomonella* Walch.
18. *Prays citri* Bill
19. *Aonidiella auranti* Mask.
20. *Carposina sasakii* Mats.
21. *Ceroplastes sinensis* Del Guer
22. *Phylloxera vastatrix* Planch.

VI. *Bime parazite*

1. *Cuscuta* sp.
2. *Orobanche* sp.

<sup>1</sup> Signed by F. Desbans — Signé par F. Desbans.

<sup>2</sup> Signed by K. Kule — Signé par K. Kule.